



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KP.nr.27/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit “O...” Sh.p.k, të cilën e përfaqëson pronari Xh.Rr. , me seli në rrugën, p.n në Prishtinë, kundër të paditurit kompania “A...” të cilën e përfaqëson pronari N.B. , me numër fiskal, me seli në fshatin, Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti anulimi i para kontratës jashtë seance me datën 03.11.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit “O...” Sh.p.k, e ushtruar më datën 22.06.2014, kundër të paditurit kompania “A...”, për anulimin e para kontratës .

DETYROHET paditësi që të paditurit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 135.00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e marrjes së aktvendimit nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi “O...” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, më datën 22.06.2014, ka parashtruar padi kundër të paditurit kompania “A...” me seli në fshatin Komuna e Vushtrrisë, me të cilën ka kërkuar anulimin e para kontratës të lidhur më datën 14.09.2013 mes paditësit dhe të paditurit.

Në shqyrtimin përgatitor të datës 13.10.2022, nuk ka prezantuar paditësi, gjykata ka konstatuar se në bazë të fletë kthesës për dorëzim personal paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt, në adresën e dhënë në padi si dhe adresa është verifikuar në evidenca publike, pranë Agjencisë së Regjistrimit Publikë të Biznese të Kosovës (ARBK), dhe nga kjo evidencë

korrespondon se adresa është e njëjtë si në padi, ndërsa në fletë kthesë nga zyrtarët e postës është konstatuar se paditësi është shpërngulur nga kjo adresë.

Gjykata duke vepruar konform nenit 387 par.1 lidhur me nenin 116 par. 5 dhe 6, ka marr Aktvendim të datës 13.10.2022, me të cilin të gjitha dorëzimit paditësit do ti bëhen përmes afishimit dhe publikimit në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, gjithashtu është caktuar seanca përgatitore për datën 27.10.2022 me fillim në ora 13.30, dhe aktvendimi është afishuar dhe publikuar në tabelën e shpalljeve më datën 14.10.2022, bashkangjitur këtij vendimi ishin procesverbali i seancës së datës 13.10.2022 dhe thirrja për seancë të datës 27.10.2022 .

Në seancën e datës 27.10.2022, nuk ka prezantuar paditësi, për të cilin Gjykata ka dëshmi se i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për në seancë nuk e ka arsyetuar, e autorizuar e të paditurit ka propozuar që konform nenit 409 të LPK-së padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 135.00 € në emër të përfaqësimit në një seancë.

Meqenëse paditësi nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit përgatitor, mungesën e tij nuk e ka arsyetuar, edhe pse i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe ate sipas aktvendimit KP.nr. 27/22 të datës 13.10.2022, i cili është publikuar në tabelën e shpalljes, fakt i cili është vërtetuar në bazë të fletë dërgesës për dorëzim personal të datës 14.10.2022, me shënim procesverbali, thirrja dhe aktvendimi u vendos në tabelën e shpalljeve më datën 14.10.2022, ndërsa sipas fletë dërgesës për dorëzim personal të datës 21.10.2022, është konstatuar se procesverbali thirrja dhe aktvendimi u tërhoqën nga tabela e shpalljeve, përmes të cilëve gjykata konstaton se paditësi është ftuar në mënyrë të rregullt dhe sipas propozimit të autorizuarës të paditurit, bazuar në nenin 409 par.1 të LPK-së me të cilin është përcaktuar *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet”*, andaj gjykata vendosi që ta konsideroj të tërhequr padinë e paditësit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 456.1 të LPK-së, me të cilin është përcaktuar *“Paditësi që e tërheqë padinë ka për detyrë që të paditurit t’ia shpërblej shpenzimet procedurale përveçse kur tërheqjen e padisë e ka bërë menjëherë pas përmbushjes së detyrimit nga ana e të paditurit”*, e në rastin konkretë me që padia e paditësit është konsideruar e tërhequr, dhe i padituri i ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe ate në shumë prej 135.00 € në emër të përfaqësimit për një seancë.

Nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 409 par.1 dhe nenit 456 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.27/22 me datë 03.11.2022

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.